



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 01/109  
Datë: 12.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 108 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/109  
Datë: 12.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L - 177, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2010, mori

**V E N D I M**

1. Autorizohet Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që të aprovojë transfere nga programi - Shpenzimet e Paparashikuara për shumat individuale të kërkuara deri në vlerën 20.000 (njëzetmijë) euro.
2. Shuma e totalit të këtij autorizimi nuk mund të kalojë 20% (njëzet për qind) të shumës së ndarë vjetore të programit - shpenzimet e paparashikuara.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen deri më 31.12.2010.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/109

Datë: 12.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e Ministrisë për Komunitetet dhe Kthim, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009 - 2013.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/109  
Datë: 12.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010 - 2020.
2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/109  
Datë: 12.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 34.21 dhe 34.22 të Ligjit Nr. 03/L - 158 për Ndryshimin e Ligjit Nr. 2003/17 për Prokurimin Publik të Ndryshuar me Ligjin Nr. 02/L - 99, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2010, mori

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 02/79, i datës 27.08.2009**

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë Nr. 02/79, i datës 27.08.2009.
2. Nën pikën 2. të vendimit Nr. 02/79, shtohet pika 3. si vijon :

“Nënshkrimin e kontratave për blerjen e objekteve për Ambasada të Republikës së Kosovës e bënë Drejtori i Prokurimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në pajtim me kërkesat e nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L - 158, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/17 për Prokurimin Publik të ndryshuar me Ligjin Nr. 02/ L - 99 ”.

3. Pika 3. e vendimit Nr. 02/79, bëhet pika 4.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/109

Datë: 12.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, me propozimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2010, mori

**V E N D I M**

1. I lejohet Universitetit të Prizrenit të angazhojë një institut apo qendër konsulente e cila do ta mbështesë menaxhmentin e Universitetit të Prizrenit në hartimin e Planit të Zhvillimit, duke u bazuar në studimin e fizibilitetit.
2. Obligohen Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/109

Datë: 12.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2010, mori

V E N D I M

1. Në përputhje me mundësitë buxhetore, nga data 01 janar 2010 ngriten pensionet personale dhe familjare për invalidët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
2. Baza për pagesë të pensioneve të invalidëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të jetë e nivelit të njëjtë me pensionet familjare të familjeve të dëshmorëve, ku pensioni më i lartë do të jetë 239 (dyqindetridhjetenëntë) euro, ndërsa ai i nivelit më të ulët do të jetë 120 (njëqindnjëzet) euro.
3. Pagesa e pensioneve invalidore do të bëhet në përputhje me shkallën e invaliditetit të invalidëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të përcaktuara në nenin 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 02/L - 2 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës.
4. Pagesa e pensioneve sipas kësaj metodologjie, të përcaktuar në pikën 2. dhe 3. të këtij vendimi, do të bëhet deri në hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës, i cili është i paraparë me Strategjinë Legjislative të vitit 2010 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

5. Për zbatimin e drejtë dhe efikas të këtij vendimi, mjetet do të sigurohen nga fondet ekzistuese të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Në rast të pamjaftueshmërisë së këtij fondi për këtë destinacion edhe pas përpjekjeve për gjetje të burimeve financiare brenda Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave që në proceset e rregullta të rishikimit të buxhetit të sigurojë fonde të mjaftueshme.
6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pasqyra tabelore e shumave të pensioneve të ngritura për invalidët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e përgatitur nga Zyra e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zyrën e Kryeministrit.
7. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe ka efekt retroaktiv nga 01 janari 2010.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo Rada i Socialne Zastite - Ministry of Labour and Social Welfare*

Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Voldimave Civile /  
 Departman Porodica Palih Boraca, Ratih Invalida i Civilnih Žrtava / Department for Martyr Families, Invalids of War and Civil Victims

Tabela e përgatitur sipas propozimit për ngritjen e pensioneve të Invalidëve të UÇK-së për vitin 2010

Nr invalideve aktual	% e invaliditetit	Pagesa Aktuale	Shuma mujore aktuale	Pagesa sipas propozimit me te ri per ngritjen e pensioneve te invalideve te UÇK-së	Pagesa mujore me ndryshim
1196	20-30%	59.60 €	71,281.60 €	120	143,520.00
			0.00 €		
1075	31-40%	77.8	83,635.00 €	170	182,750.00
			0.00 €		
359	41-50%	96	34,464.00 €	190	68,210.00
			0.00 €		
126	51-60%	114.2	14,389.20 €	200	25,200.00
			0.00 €		
66	61-70%	132.4	8,738.40 €	210	13,860.00
			0.00 €		
38	71-80%	150.6	5,722.80 €	220	8,360.00
			0.00 €		
75	81-100%	187	14,025.00 €	239	17,925.00
<b>TOTALI</b>	<b>MUJORE</b>		<b>232,256.00 €</b>		<b>459,825.00</b>
	<b>VJETORE</b>		<b>2,787,072.00 €</b>		<b>5,517,900.00</b>

<b>Ndryshimi</b>		<b>2,730,828.00</b>
<b>Parashikimi për rritjen e numrit të Invalidëve</b>		<b>293,825.32</b>
<b>Totali</b>		<b>3,024,653.32</b>

Parashikojmë që gjatë vitit 2010 të drejtën në pension do ta realizojnë edhe 294 Invalidë ,duke marrë për bazë pagesën mesatare të pensioneve sipas propozimit të ri nevoiten edhe 293,285.32 € ,për çdo muaj llogarisim se të drejtën do ta fitojnë nga 24 invalidë

Tabela e përgatitur sipas propozimit për ngritjen e pensioneve për kujdestarët e nvalideve të UÇK-së për vitin 2010 me shkallë prej 81-100%

Nr invalideve aktual	% e invaliditetit	Pagesa Aktuale	Shuma mujore aktuale	Pagesa sipas propozimit me te ri per ngritjen e pensioneve te invalideve te UÇK-së	Pagesa mujore me ndryshim
58	81-100%	59.60 €	3,456.80 €	120	6,960.00
			0.00 €		
<b>TOTALI</b>	<b>MUJORE</b>		<b>3,456.80 €</b>		<b>6,960.00</b>
	<b>VJETORE</b>		<b>41,481.60 €</b>		<b>83,520.00</b>
	<b>Ndryshimi</b>				<b>42,038.40</b>

Tabela e përgatitur sipas propozimit për ngritjen e pensioneve të Familjeve pas vdekjes së Invalideve të UÇK-së për vitin 2010

Nr invalideve aktual	% e invaliditetit	Pagesa Aktuale	Shuma mujore aktuale	Pagesa sipas propozimit me të ri për ngritjen e pensioneve të invalideve të UÇK-së	Pagesa mujore me ndryshim
10	20-30%	48.68 €	486.80 €	96	960.00
13	31-40%	63.24	822.12 €	136	1,768.00
4	41-50%	77.8	311.20 €	152	608.00
2	51-60%	92.36	184.72 €	160	320.00
2	61-70%	106.92	213.84 €	168	336.00
2	71-80%	121.48	242.96 €	176	352.00
5	81-100%	150.6	753.00 €	191.2	956.00
<b>TOTALI</b>	<b>MUJORE</b>		<b>3,014.64 €</b>		<b>5,300.00</b>
	<b>VJETORE</b>		<b>36,175.68 €</b>		<b>63,600.00</b>
	<b>Ndryshimi</b>				<b>27,424.32</b>

Mjetet që nevoiten shtesë me propozimin e ri

Invalidët e UÇK-së	3,024,653.32
Kujdestarët e Invalidëve	42,038.40
Familjet e Invalideve pas vdekjes	27,424.32
<b>Totali</b>	<b>3,094,116.04</b>

Kjo tabelë është punuar nga Departamenti I FDI L-së sipas propozimit për ngritjen e pensioneve të Invalidëve të UÇK-së dhe Kujdestarëve të Invalidëve me shkallë invaliditeti prej 81-100% në bazë të propozimit nga Zyra e Veteranëve pran Krueminitrit , ndersa pensioni familjar pas vdekjes së invalidit të UÇK së është llogaritur duke u bazuar në Ligjin 02/L-2